



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1652, datë 18.07.2011**

**Për**

**“Fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 18.07.2011, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S :**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

Shkresa e sipërmarrësit ABCom sh.p.k me nr. 133 prot, datë 05.04.2011, (AKEP: nr. 301/1 prot, datë 05.04.2011), “Ankim mbi lidhjen e marrëveshjes së intekoneksionit me sipërmarrësin me fuqi të ndjeshme në treg Eagle Mobile sh.a”, bashkëlidhur korrespondenca shkresore midis palëve si më poshtë:

- Shkresa e ABCom drejtuar Eagle Mobile me nr. 57 prot, datë 15.02.2011 (AKEP: nr. 301, dt. 16.02.2011), “Kërkesë për lidhjen e MI”;
- Shkresa e Eagle Mobile nr. 628 prot, dt. 18.02.2011, (AKEP: 327 prot, date 18.02.2011) , “Përgjigje kërkesës tuaj për lidhje MI”, drejtuar ABCom dhe për dijeni AKEP;
- Shkresa e ABCom nr. 156/1 prot, datë 15.04.2011 (AKEP: nr. 301/2, dt. 15.04.2011); “Kërkesë për lidhjene MI”, drejtuar Eagle Mobile dhe për dijeni AKEP;
- Shkresa e AKEP nr. 301/5 prot, datë 26.04.2011, “Mbi përgjigjen e shkresave të ABCom sh.p.k të depozituara në AKEP dt. 05.04.2011 dhe nr. 156/1 dt. 15.04.2011”, drejtuar ABCom dhe Eagle Mobile;
- Shkresa e Eagle Mobile nr. 1960 prot, datë 16.05.2011 (AKEP: nr. 301/6 prot, datë 16.05.2011) “Përgjigje kërkesës tuaj për lidhje MI” drejtuar ABCom dhe për dijeni AKEP;
- Shkresa e AKEP nr. 703/13 prot, datë 06.06.2011 “Kërkesë për informacion mbi vijushmërinë e negociatave për lidhjen e MI”, drejtuar ABCom dhe Eagle Mobile;
- Shkresa e Eagle Mobile nr. 2277 prot, dt. 10.06.2011 “Mbi dokumentacionin e nevojshëm për MI”, drejtuar ABCom dhe për dijeni AKEP;
- Shkresa e ABCom nr. 580/1 prot, dt. 16.06.2011 (AKEP: nr. 934/4 prot, dt. 16.06.2011), “Përgjigje shkresës tuaj nr. 2272 prot, dt. 10.06.2010”, drejtuar Eagle Mobile dhe për dijeni AKEP;
- Shkresa Eagle Mobile nr. 2319 prot, dt. 15.06.2011 (AKEP: 934/5, dt. 17.06.2011), “Përgjigje shkresave tuaja mbi vijushmërinë e negociatave për lidhjen e MI me operatorët Alternativë Neofone sh.p.k dhe ABCom sh.p.k”, drejtuar AKEP;
- Shkresa e ABCom sh.p.k nr. 404, dt. 07.07.2011 (AKEP: nr. 301/7, datë 08.07.2011), “Kërkojmë përgjigje për ankimin administrativ nr. 133, dt. 05.04.2011”, drejtuar AKEP;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- si dhe, duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

ABCom sh.p.k, me shkresën nr. 133 prot, datë 05.04.2011 (AKEP: nr. 301/1 prot, datë 05.04.2011) “Akim për moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit brenda afateve ligjore midis operatorëve ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a” sqaron se:

1. ABCom i drejtohet për herë të parë Eagle Mobile me kërkesën për të lidhur marrëveshje interkoneksioni me anë të shkresës nr. 848/1 prot, dt. 27.10.2010 duke i kërkuar Eagle lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit;
2. Eagle Mobile me anë të shkresës nr. 5087 prot, datë 15.11.2010 bën me dije ABCom se do të konsiderojë lidhjen e MI me Operatorët Alternative, pas miratimit dhe publikimit të RIO-së së Eagle Mobile në zbatim të Vendimit nr. 1346, datë 23.07.2010 të KD të AKEP dhe kuadrit rregulator në fuqi;
3. ABCom me shkresën nr. 57 prot, më datë 15.02.2011, pas miratimit nga AKEP të RIO së Eagle Mobile me anë të VKD nr. 1467, datë 23.12.2010 i drejtohet sërish Eagle Mobile për lidhjen e MI;
4. Eagle Mobile me shkresën nr. 628 prot, datë 18.02.2011 njofton ABCom se, Eagle Mobile është në procedim administrativ duke ankimuar Vendimin nr. 1467, datë 23.12.2010 të KD të AKEP, dhe për pasojë ky ankimim administrativ e pezullon zbatimin e Vendimit deri në shqyrtimin e ankimit nga AKEP, dhe nxjerrjen e nje vendimi administrativ;
5. ABCom konsideron se, me gjithë kërkesat e ABCom drejtuar Eagle Mobile për lidhjen e MI, Eagle Mobile nuk i është përgjigjur kërkesës së ABCom duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9918, si dhe në tejkalim të afatit të përcaktuar në nenin 50 të Ligjit nr. 9918, ABCom i kërkon AKEP me shkresën nr.133, date 05.04.2011 që në zbatim të neneve 31-46, 50, 60 të Ligjit nr. 9918 dhe kuadrit rregullator në fuqi, të urdhërojë Eagle Mobile të lidhë MI me ABCom;
6. AKEP, pasi u njoh me shkresën e mësipërme, filloi trajtimin administrativ të ankimit të Eagle Mobile dhe në përfundim nxorri Vendimin nr. 1539, dt. 31.03.2011 “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Eagle Mobile ndaj Vendimit nr. 1467, dt 23.12.2010 të KD të AKEP”, me anë të shkresës nr. 301/5, dt 26.04.2011, i është drejtuar sipërmarrësve ABCom dhe Eagle Mobile, duke i bërë me dije se AKEP është duke ndjekur me vëmendje zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara për sipërmarrësin me fuqi të ndjeshme në treg për sigurimin e aksit dhe interkoneksionit palës së interesuar;
7. Eagle Mobile me anë të shkresës me nr. 1960, datë 16.05.2011, per dijeni AKEP,e ka njoftuar ABCom se Eagle Mobile është përsëri në nje tjetër procedim administrativ ndaj Vendimit nr. 1560, datë 20.04.2011 të KD të AKEP “Për disa shtesa dhe ndryshime në ORI të Eagle Mobile” dhe se Eagle Mobile në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi do të trajtojë kërkesat e operatorëve për interkoneksion pas marrjes së një Vendimi tjetër të AKEP për shqyrtimin e ankimit te dYTE administrativ ndaj VKD nr. 1560, datë 20.04.2011;
8. AKEP ka shqyrtuar ankimimin e dYTE te Eagle Mobile dhe ka nxjerrë Vendimin nr. 1601, dt. 30.05.2011 “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Eagle Mobile ndaj Vendimit nr. 1560, dt 20.04.2011 të KD të AKEP”, me anë të të cilit ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit nr. 1560, dt. 20.04.2011.

- Me anë të shkresës nr. 703/13 prot, datë 06.06.2011, AKEP i është drejtuar sërish të dy sipermarrësve ABCom dhe Eagle Mobile, duke iu kërkuar të paraqesin informacion në AKEP se si po vijojnë negociatat midis tyre për lidhjen e MI, duke iu vendosur si afat maksimal të dergimit të informacionit datën 13.06.2011;
9. Pas shkresës së AKEP, Eagle Mobile me anë të shkresës nr. 2277 prot, datë 10.06.2011 *“Mbi dokumentacionin e nevojshëm për lidhjen e MI”*, i drejtohet ABCom duke i kërkuar depozitimin e:
- Dokumentacionit ligjor në zbatim të pikës 8.4 të ORI të Eagle Mobile;
  - Dokumentacionit të nevojshëm që konfirmon plotësimin e të gjitha kërkesave të ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrave për analizën dhe rrugëzimin e thirrjeve në destinacion;
  - Si dhe garancinë e përmbushjes së detyrimeve ligjore mbi lejimin e përgjimit në zbatim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 dhe të Ligjit nr. 9157 date 04.12.2003;
10. ABCom me anë të shkresës nr. 580/1, datë 16.06.2011, (AKEP: nr. 934/4 prot, dt. 16.06.2011), *“Përgjigje shkresës tuaj nr. 2277, datë 10.06.2011”*, drejtuar Eagle Mobile dhe për dijeni AKEP thekson se ABCom:
- Zotëron të gjithë dokumentacionin shkresor të nevojshëm në zbatim të pikës 8.4 të ORI së Eagle Mobile;
  - ABCom ka realizuar me sukses të gjithë procesin për administrativ dhe teknik për portimin e numrit rigorozisht sipas kërkesave të AKEP për këtë projekt, duke realizuar me sukses ofrimin e shërbimit të portimit të numrave së bashku me analizën e dhe rrugëzimin e thirrjeve në destinacion dhe se ky është një proces që po vijon normalisht me Operatorët e tjere me FNT;
  - ABCom si operator i shërbimeve elektronike veprimtarive e tij, e ka të bazuar në respektimin e çdo detyrimi ligjor në zbatim të ligjit nr. 9918, dhe nr. 9157;
  - Për sa më sipër ABCom i kërkon Eagle Mobile, në zbatim të kuadrit ligjor dhe Rregulloren për Aksesin dhe interkoneksionin mbi afatet e parashikuara për lidhjen e MI;
11. Eagle Mobile sh.a me anë të shkresës nr. 2319 prot, dt. 15.06.2011 (AKEP: 934/5 prot, dt. 17.06.2011), *“Përgjigje shkresave tuaja mbi vijushmërinë e negociatave për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit me operatorët alternative Neofone dhe ABCom”* i drejtohet AKEP, duke e informuar se Eagle Mobile në zbatim të ligjit nr. 9918, dhe kuadrit rregullator në fuqi i ka kërkuar operatorit ABCom, dokumentacionin e nevojshëm ligjor për fillimin e procedurave për lidhjen e MI midis palëve;
12. ABCom, pas gjithë korrespondencës shkresore midis Eagle dhe AKEP, me anë të shkresës nr. 404 prot, datë 07.07.2011 (AKEP: 301/7 prot, datë 08.07.2011), i drejtohet AKEP me kërkesën për shqyrtim dhe marrjen e një Vendimi mbi ankimin me shkresën nr. 133 prot, datë 05.04.2011 ndaj sipërmarrësit Eagle Mobile;
13. Për sa më sipër, ankimi administrativ i paraqitur nga sipërmarrësi ABCom sh.p.k me shkresën nr. 133 prot, datë 05.04.2011 (AKEP: nr. 301/1 prot, 05.04.2011) është në përputhje me:
- Pikën 1, të nenit 50, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, *“Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”*;

- Rregulloren nr. 18, datë 11.06.2010, “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” miratuar me VKD nr. 1296 datë 11.06.2010;
14. Duke qënë se, sipërmarrësit ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a megjithë negociatat, dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit midis tyre, AKEP në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 te nenit 115, te Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 te Rregullores së Brëndshme,

### **V E N D O S:**

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a.;
  2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
    - Jonida GJIKA Kryetar
    - Jetmir BRAHA Anëtar
    - Ded JAKAJ Anëtar
    - Florida ÇELA Anëtar
    - Esmeralda DERVISHI Anëtar
  3. Të njoftohen palët e interesuara ABCom sh.p.k dhe Eagle Mobile sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
  4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
  5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARË:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**